

Pogradec, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS

“Blerje Traktor + Frezë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

16000000-5 Makineri Bujqësore 16700000-2 Traktorë 16720000-8 Traktorë të Përdorura

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 861 000 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjet e një mijë) lekë pa tvsh, me burim financimi : Burimi i financimit: “Vetë - financim”, miratuar me VKB Nr.128, datë 22.12.2025 ”Për Miratimin dhe Detajimin e Buxhetit të Bashkisë Pogradec për Vitin 2026”.

***Argumentimi i fondit limit:** Fondi limit u përllorgarit nga grupi i punës i ngritur me urdhër Nr.3 datë 19.02.2026 të titullarit të Autoritetit kontraktor (AK), me lendë: ”Për ngritjen e Grupit te Punes per përllorgaritjen e fondit limit, specifikimeve teknike si dhe kushteve të veçanta të kualifikimit” për prokurimin publik me objekt: “Blerje Traktor + Frezë”.*

Pas hartimit të specifikimeve teknike /termave të referencës grupi i punës i është drejtuar tregut për përllorgaritjen e fondit limit mbështetur në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në VKM-në Nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Neni 76 “Mënyrat për përllorgaritjen e vlerës së prokurimit” ku thuhet se:1. *Në përllorgaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:*

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Grupi i punës me qëllim që fondi limit të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe të mos abuzohet në përlllogaritjen e tij vendosi të testojë tregun në subjekte, që operojnë në fushën e tregtimit të mjeteve. Bazuar në çmimin mesatar të ofertave të marra rezultoi fondi limit rezulton në vlerën prej **1 861 000 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjet e një mijë)**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e fondit limit, specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9.**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, te ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.te ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore financiare të 3 (tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, neni 43, pika 2, gërma c) pasi fondi limit i procedurës së prokurimit ndodhet nën kufirin e ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka

ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqese për mjetin që oferton, Katalog /Skedë teknike /Librezë /Leje qarkullimi, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. (Llojin e mjetit, marka, modeli, viti i prodhimit, numri i identifikimit të tij).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallit te kerkuara sipas AK.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë garancie 6-mujore për: Garanci për eliminimin, pa shpërblim, të defekteve të mundshme motorrike,

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”te ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”te ndryshuar. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se për një periudhë të arsyeshme prej 1 viti, malli objekt prokurimi do të përmbushë specifikimet teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat qe mund te lindin, jo për faj të Autoritetit.

2.3.4 Deklaratë që mjete është ne gjendje te mire te jashtme dhe te brendshme (pa gervishje, goditje apo defekte ne pjeset gjenerike dhe motorrike)

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”te ndryshuar . Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se malli objekt prokurimi do të përmbushë specifikimet teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat qe mund te lindin, jo për faj të Autoritetit. Gjithashtu , nisur nga fakti qe po blihet nje automjet I perdorur, AK me te drejte kerkon te sigurohet per gjendjen e mjetit qe do te bleje.

2.3.5 Deklaratë që do të beje kalimin e mjetit në pronësi të Bashkisë Pogradec pas dorëzimit të tij. Automjeti që do të dorëzohet pranë autoritetit kontraktor të jetë i shoqëruar me këto dokumenta:

- Leja e qarkullimit.
- Çertifikatë të vlefshme e Kontrollit Teknik
- Siguracioni i mjetit i vlefshëm.
- Taksat të vlefshme

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar . Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se malli objekt prokurimi do të përmbushë specifikimet teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat që mund të lindin, jo për faj të Autoritetit. Gjithashtu , nisur nga fakti që po blihet një automjet i përdorur , AK me të drejte kërkon të sigurohet për gjendjen e mjetit që do të bleje dhe dokumentacionin e rregullt me të cilin kërkon të jetë i pajisur një mjet sipas Legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), ose ekuivalent.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës, në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, te ndryshuar si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar.

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja per automjetin e kerkuar nga AK si dhe nga problematikat qe lindin ne terren per AK.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT: